

# Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit të Kosovës (ARRU)

---

## Përgjigje për

## Konsultimin rreth politikës së ardhshme të tarifës për furnizim me ujë

Prill 2024

---

### 1 Konsultimi

---

- 1.1 Më 24 janar 2024 publikuam një dokument konsultimi duke paraqitur propozimet tona fillestare për një rishikim të ardhshëm të kornizës për përcaktimin e tarifës për furnizim me ujë dhe për sektorin e shërbimeve të ujërave të ndotura në Kosovë.
- 1.2 Dokumenti i konsultimit mund të gjendet në [\[chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/lajmet/Tariff%20policy%20consultation\\_shqip.pdf\]](https://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/lajmet/Tariff%20policy%20consultation_shqip.pdf)
- 1.3 Në këtë konsultim, kemi kërkuar opinione nga akterë në shumë fusha duke përfshirë:
- Parimet e përgjithshme të tarifimit dhe roli i rregullatorit.
  - Masat nxitëse për përmirësimin e efikasitetit operativ.
  - Masat aktuale nxitëse për t'i shtyrë përmirësimet e efikasitetit.
  - Investimet kapitale.
  - Planet e biznesit me cilësi të dobët.
  - Largimi gradual i ndër-subvencionimit aktual.
  - Zëvendësimi i tarifave fikse me një tarifë të bazuar në madhësinë e lidhjes.
  - Tarifa infrastrukturore e mbi ngarkesës .
  - Vlerësimi i tarifave të ujërave të ndotura.
  - Tarifat e ujërave të ndotura bazuar në vëllimin dhe cilësinë e shkarkimeve të ujërave të ndotura.
  - Mbrojtja e konsumatorëve të cenueshëm.
- 1.4 Për këtë konsultim i kemi marrë vetëm gjashtë përgjigje nga: KRU-të, Qeveria, investitorët dhe konsulentët që punojnë në sektorin e furnizimit me ujë. Do të kishim preferuar një nivel më të madh të përgjigjeve por përgjigjet që i kemi marrë na kanë ofruar udhëzime për të ardhmen.

### 2 Përgjigjet

---

#### 2.1 Parimet e përgjithshme të tarifimit dhe roli i rregullatorit.

- 2.1 Gjatë konsultimeve tona, kemi mbajtur qëndrimin që parimet themelore që e mbështesin kornizën rregullative duhet të mbesin të pandryshuara. Shumica e të anketuarve e kanë përkrahur këtë qëndrim.

- 2.2 Një i anketuar ka propozuar që parimet mund të avancohen duke e përfshirë qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale në vendim-marrjen për tarifa aty ku është e mundur. Në rastet kur Ofruesit e Shërbimeve përfshijnë në parashtrësit e planeve të tyre të biznesit aktivitete që janë të nevojshme për t'i përmbushur standardet e detyrueshme mjedisore dhe të tjera, në anën tjetër, ne jemi të detyruar t'i lejojmë kostot e aktiviteteve të tilla në planet e tyre të biznesit me kusht që ato të jenë të drejta dhe të arsyeshme. Interpretimi ynë i detyrave tona aktuale është që megjithëse ne e mbështesim mbrojtjen e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale, nuk mund të jetë me çdo lloj çmimi. Për shembull, nëse një KRU i ka dy opsione për projekte nga të cilat duhet të zgjedhë dhe Opsioni A është më i përshtatshëm për mjedisin se sa Opsioni B por Opsioni A është më i shtrenjtë se Opsioni B, atëherë opsioni i përzgjedhur duhet të bazohet në një ekuilibër mes nevojave të mjedisit dhe interesave të konsumatorëve, ofruesve të shërbimeve dhe akterëve të tjerë. Metodologjia që merr parasysh kostot ekonomike (jo vetëm financiare) dhe përfitimet e vendim marrjes për investime mund të ndihmojë në përcaktimin e opsionit më të mirë për investim, p.sh. duke i dhënë vlera ekonomike emetimeve të reduktuara të karbonit. Ne do të punojmë me qeverinë për të hartuar udhëzues për KRU-të për t'i aplikuar në analizat e tyre të vendim-marrjes për investime. Po ashtu, do të marrim opinion ligjor për atë se a kemi kompetenca për të përdorur një qasje proaktive ndaj përfshirjes së qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale në vendim-marrjen tonë dhe, nëse është e nevojshme, mund të kërkojmë një ndryshim në legjislacion dhe/ose në drejtimin e politikës së qeverisë.
- 2.3 Një i anketuar ka komentuar për kornizën aktuale që objektet fetare nuk tarifohen për furnizimin me ujë dhe që kjo pozitë duhet të rishqyrtohet në rishikimin e ardhshëm për tarifa. Këtë aspekt do ta shqyrtojmë në rishikim.

## **2.2 Mbulimi i kostos – masat nxitëse për efikasitet të përmirësuar operativ**

- 2.4 Shumica e të anketuarve e kanë përkrahur konceptin e ofrimit të masave nxitëse për përmirësim të performancës dhe nuk është paraqitur ndonjë preferencë domethënëse për ndonjërin prej dy opsioneve. Megjithatë, një i anketuar ka theksuar një pengesë të mundshme ligjore ndaj këtyre propozimeve pasi që bonuset mund tu jepen vetëm anëtarëve të Bordeve të Drejtorëve të KRU-ve dhe janë të kufizuara deri në 50% të honorarit të tyre themelor (neni 12 i Ligjit 04/L-111). I anketuari nënvizoi që kjo do të duhej të zbatohet përmes një procesi të mbikëqyrjes së performancës nga Ministria e Ekonomisë sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Këtë çështje do ta shqyrtojmë më hollësisht dhe do të konsultohemi me Ministrinë e Ekonomisë për ta përcaktuar rrugën më praktike për ta nxitur përmirësimin e performancës.
- 2.5 Një i anketuar ka sugjeruar që masat nxitëse për performancën duhet të shoqërohen me ndëshkime për mos përmbushjen e pritshmërive të performancës. Edhe pse kjo qasje është me vend nëse KRU-të do të ishin në pronësi të sektorit privat dhe ndëshkimet e tilla do të ndikonin në kthimin e aksionarëve, jemi të shqetësuar që ndëshkimet financiare të aplikuar ndaj KRU-ve publike do ta përkeqësonin situatën duke i privuar ata prej burimeve shumë të nevojshme financiare. Do ta shqyrtojmë këtë opsion të ndëshkimeve për tu aplikuar ndaj KRU-ve por do t'i kemi parasysh pasojat e mundshme të paqëndrueshme të një qasjeje të tillë.

## **2.3 Mbulimi i kostos – masat aktuale nxitëse për t'i shtyrë përmirësimet e efikasitetit.**

- 2.6 Shumica e të anketuarve janë pajtuar që procesi i përcaktimit të tarifës duhet të ndryshohet për ta larguar masën e mundshme nxitëse për shtyrjen e nismave për përmirësimin e efikasitetit. Do ta zhvillojmë një modul në model rreth këtij koncepti.

## **2.4 Mbulimi i kostos – investimet kapitale**

- 2.7 Shumica e të anketuarve janë pajtuar që duhet të bëhet diçka urgjente për të siguruar që investimet realizohen siç janë paraparë me planet e biznesit të KRU-ve. Kishte konsensus të arsyeshëm që opsioni i një llogarie të dedikuar për aktivitetet e investimeve mund të mos jetë praktik dhe që preferohet qasja e ndëshkimeve. Një i anketuar sugjeroi që qasja e ndëshkimeve mund të ndryshohet në një ku të ardhurat e pashpenzuara duhet të shtrihen në periudhën e ardhshme të rishikimit. Pra, ajo që ndodh me ndëshkim të tillë, d.m.th. të ardhurat e shoqëruara me një investim që nuk është materializuar në

një periudhë të caktuar të rishikimit të tarifave do të shtrihet në periudhën e ardhshme nëse ai investim është përsëritur në planin e biznesit.

- 2.8 Një i anketuar nuk e ka mbështetur qasjen e ndëshkimeve pasi që do të shkaktonte stres të panevojshëm financiar mbi KRU-të dhe që qasja aktuale e turpërimit publik duhet të vazhdojë dhe atëherë kur aplikohen sanksione ato duhet të jenë përmes kompetencave që ua jep Qeveria Bordeve të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të KRU-ve.
- 2.9 Një i anketuar ka sugjeruar që ndëshkimi duhet të shoqërohet me penalti financiare aty ku është e përshtatshme. Ne konsiderojmë që kjo mund të shkaktojë penalizim të tepërt për KRU-të dhe që qasja e ndëshkimeve reflekton kostot dhe konsumatorët do të përfitojnë prej saj.
- 2.10 Të anketuarit sugjeruan që ndëshkimi nuk duhet të fillojë deri në periudhën e rishikimit të tarifës 2028-2030 e më tutje pasi që do të ketë kohë të mjaftueshme që KRU-të t'i përgjigjen një procesi të ndëshkimit të mëhershëm. Do ta shqyrtojmë këtë opinion gjatë rishikimit tonë të kornizës për përcaktimin e tarifave.

## **2.5 Mbulimi i kostos –planet e biznesit me cilësi të dobët.**

- 2.11 Shumica e të anketuarve e kanë mbështetur konceptin e një mase nxitëse për të paraqitur plane të biznesit të cilësisë së lartë. Kjo është e ndërlidhur me çështjen e investimeve që nuk realizohen siç u cek më sipër, pra plani i biznesit i cilësisë së lartë duhet të paraqesë dëshmi të fuqishme për ta mbështetur planin e investimit që na jep një shkallë të lartë të sigurisë që investimet në plan do të realizohen. Do ta shikojmë këtë më hollësisht dhe nëse vendosim ta shtyjmë përpara do të përcaktojmë kritere për mënyrën se si duhet të vlerësohen planet.
- 2.12 Një i anketuar nuk e ka mbështetur konceptin e kthimit më të lartë por përcaktimin e standardeve të cilësisë së pritur dhe që dështimi për t'iu përmbajtur atyre të rezultojë në refuzim të planit. Nuk konsiderojmë që kjo qasje është e zbatueshme pasi që e kemi për detyrë të bëjmë rishikimeve të tarifave dhe refuzimi i menjëhershëm i një plani pa arsye të mirë mund të jetë në kundërshtim me këtë detyrë. Në disa raste, biznesi me cilësi të dobët mund të jetë i ndërlidhur me ndryshime në stafin e KRU-së ku stafi i ri nuk i njeherë kërkesat. Duhet ta balancojmë dëshirën për të pasur plane të cilësisë së lartë me atë që mund të presim arsyeshëm që mund të arrihet brenda rrethanave të një KRU-je.

## **2.6 Kosto reflektive – largimi i ndër-subvencionimit aktual**

- 2.13 Shumica e të anketuarve janë pajtuar që ndër-subvencionimi aktual duhet të largohet por gradualisht dhe që duhet të sigurohemi që konsumatorët e cënueshëm nuk penalizohen. Këtë do ta shqyrtojmë më hollësisht për ta përcaktuar një kornizë të përshtatshme kohore për largimin e tij.

## **2.7 Reflektimi i kostos – zëvendësimi i tarifave fikse me tarifa të bazuara në madhësinë e lidhjes.**

- 2.14 Të gjithë të anketuarit e kanë mbështetur konceptin e zëvendësimit të tarifave aktuale fikse me tarifa të bazuara në madhësinë e lidhjes. Nuk shohim ndonjë arsye pse nuk mund të shtyhet përpara ky propozim. Prandaj, shumë shpejt do t'i informojmë KRU-të me propozimet tona me kohë që të mund t'i mbledhin informatat e nevojshme për paraqitjen e tarifave të tyre dhe që të mund ta ndryshojnë sistemin e faturimit për ta përfshirë ndryshimin e tillë.

## **2.8 Kosto reflektive – tarifa infrastrukturore e mbi ngarkesës.**

- 2.15 Shumica e të anketuarve e kanë mbështetur konceptin që çdo kosto infrastrukturore e mbi ngarkesës që nxiten nga zhvillimi i ri duhet të financohen nga zhvilluesit e jo nga marrëveshjet ekzistuese ku kostot e tilla absorbohen në tarifën për të gjithë konsumatorët.
- 2.16 Tarifën e propozuar prej EUR 110.00 për ujë dhe EUR 90.00 për ujërat e ndotura janë konsideruar më të arsyeshme nga shumica e të anketuarve.

2.17 Kishte konsensus që shpenzimi duhet të reflektohet në tarifë si kredi për avancimin e infrastrukturës që do të ofrojë një përfitim të vogël por të përhershëm për konsumatorët ekzistues. Kjo është në përputhje me konceptin që përforcimi i rrjetit është, sipas definicionit, avancim e jo ripërtëritje.

2.18 Do të përgatisim dhe do të nxjerrim udhëzues për KRU-të për mënyrën se si duhet të aplikohen tarifa infrastrukturore e mbi ngarkesës. Këtu do të përfshihen udhëzimet për mënyrën se si të tarifohen vendbanimet e reja që i zëvendësojnë ato ekzistuese dhe se si të përcaktohet një tarifë e përshtatshme për konsumatorët e ri jo shtëpiakë.

## 2.9 Kosto reflektive – tarifat e vlerësuara për ujërat e ndotura

2.19 Të gjithë të anketuarit janë pajtuar që tarifat për ujëra të ndotura janë të përshtatshme për konsumatorët që i kanë burimet e tyre ujore ose që gjenerojnë ujëra të ndotura nga produktet që nuk shoqërohen me furnizimin e ujit nga KRU-të.

2.20 Kishte disa keqkuptime për mënyrën se si me këtë do të nevojitej një tarifë tjetër nga tarifa aktuale për shkak të faktorëve të kthimit. Ne do të nxjerrim udhëzime shpjeguese për KRU-të për mënyrën se si duhet t'i përcaktojnë rrjedhat dhe ngarkesat e vlerësuara dhe si duhet të akomodohen në planet e biznesit.

## 2.10 Kosto reflektive – tarifat e ujërave të ndotura bazuar në volumin dhe cilësinë e shkarkimit të ujërave të ndotura

2.21 Në propozimet tona për tarifim për ujërat e ndotura të bazuar në cilësi për konsumatorët e mëdhenj industrial kishte përgjigje të përziera. Disa të anketuar e kanë mbështetur konceptin e marrëveshjes së tarifimit për ujërat e ndotura ndërsa të tjerët kanë deklaruar se këto janë të panevojshme nëse të gjithë përdoruesit jo shtëpiakë i trajtojnë paraprakisht ujërat e tyre të ndotura sipas vlerave kufitare të përcaktuara në legjislacion dhe të zbatuara nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

2.22 Opinioni ynë është se legjislacioni aktual lejon interpretime të ndryshme. Një interpretim është se vlerat kufitare zbatohen kudo, pavarësisht nëse impianti për trajtimin e ujërave të ndotura është në funksion dhe i trajton ujërat e ndotura përpara shkarkimit në mjedis. Ky interpretim qëndron nëse nuk ka impiant për trajtimin e ujërave të ndotura, siç ishte rasti për shumë vite deri në dekadën e fundit apo më shumë kur ka pasur investime të mëdha në trajtimin e ujërave të ndotura në të gjithë vendin.

2.23 Tani kemi shumë impiante për trajtimin e ujërave të ndotura që i trajtojnë ujërat e ndotura në nivele të pranueshme mjedisore dhe interpretimi ynë i legjislacionit është që duhet të jetë e lejueshme që një përdorues të shkarkojë ujëra të ndotura në sistemin e kanalizimit që e tejkalon vlerën aktuale kufitare nëse më pas trajtohen nga impianti i KRU-së për trajtim dhe iu përmbahen vlerave kufitare kur shkarkohen në mjedis. Në këtë rast, zbatimi i vlerave kufitare duhet të aplikohet në pikën e hyrjes në mjedis, pra në pikën e shkarkimit të impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura dhe jo në pikën e hyrjes në sistemin e kanalizimit. Megjithatë, KRU duhet të mbajë vlera të tjera kufitare për përdoruesit në pikën e hyrjes në sistemin e kanalizimit për të siguruar që ujërat e ndotura mund të trajtohen në një nivel të kënaqshëm nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura pa i tejkaluar vlerat kufitare mjedisore kur ujërat e ndotura të trajtuara shkarkohen në mjedis. Vlerat e tilla kufitare mund të caktohen edhe për të siguruar që impianti i trajtimit është i mbrojtur në mënyrë adekuate.

2.24 Kur një përdorues industrial shkarkon ujëra të ndotura që janë më ndotëse se mesatarisht, konsiderojmë që përdoruesi duhet të paguajë tarifa të mbetjeve tregtare që reflektojnë kosto më të lartë të trajtimit. Përdoruesi pastaj mund të vendos nëse është e përshtatshme ekonomikisht të paguajë tarifa të trajtimit ose të investojë në para-trajtim për t'i ulur tarifat. Duke e detyruar përdoruesin t'i trajtojë paraprakisht ujërat e ndotura kur KRU lehtësisht mund t'i përmbushë standardet e shkarkimit mund të rezultojë në vendim-marrje jo efikase lidhur me investimet në dëm të ekonomisë më të gjerë. Në shumicën e ekonomive të zhvilluara, vlerat kufitare mjedisore aplikohen vetëm në pikën e hyrjes në mjedis e jo në pikën e hyrjes në sistemin e kanalizimit. Aplikimi i tarifave të mbetjeve tregtare është veçori e zakonshme kur vendimi për t'i trajtuar paraprakisht ujërat e ndotura është më i favorshëm ekonomikisht duke e krahasuar koston e trajtimit paraprak me koston e tarifave industriale. Do të

- punojmë me Qeverinë për ta qartësuar legjislacionin dhe, nëse është e nevojshme, do të kërkojmë të ndryshohet legjislacioni për t'i përmbushur konceptet që aplikohen në vendet e tjera të botës.
- 2.25 Nëse interpretimi i legjislacionit është i tillë që vlerat kufitare duhet të aplikohen në pikën hyrëse në kanalizim edhe kur ekziston një impiant i KRU-së për trajtimin e ujërave të ndotura, nuk konsiderojmë që qëllimi është të insistohet në mbylljen e menjëhershme të njësisë në fjalë derisa të investojë në trajtim paraprak për t'i përmbushur vlerat kufitare. Në vend të mbylljes së menjëhershme, ne konsiderojmë që KRU-të duhet të aplikojnë tarifa industriale që e reflektojnë koston e trajtimit deri në instalimin e trajtimit paraprak. Kjo qasje do t'i nxiste përdoruesit industrialë të investojnë në trajtim paraprak e jo të mbështeten në masat zbatuese mjedisore vetëm nga AMMK.
- 2.26 Qëndrimi ynë është që për sistemet ku nuk ka trajtim, do të prisnim që AMMK ta zbatojë me saktësi pajtueshmërinë në pikën e hyrjes në kanalizim pasi që kjo, në efekt, është pika e hyrjes në mjedis. Megjithatë, kjo mund të rezultojë në mbylljen e disa industrive me një humbje të përgjithshme ekonomike neto. Edhe pse AMMK është autoriteti kryesor zbatues në këtë aspekt, ne konsiderojmë që çdo masë zbatuese duhet të përforcohet përmes tarifave të mbetjeve tregtare ku kostoja e trajtimit të ujërave të ndotura mund të përdoret si kosto reflektive për mjedisin. Kjo do ta inkurajojë investimin në trajtim paraprak pavarësisht se a ka impiant për trajtimin e ujërave të ndotura që i shërben përdoruesit.
- 2.27 E kemi shikuar bazën e konsumatorëve të KRU-ve dhe ishin vetëm disa përdorues të mëdhenj industrialë që shkarkojnë sasi të konsiderueshme të ujërave të ndotura ku cilësia e ujërave të ndotura është dukshëm më e keqe se cilësia e ujërave të ndotura mesatare. Në disa KRU, nuk ka përdorues të tillë industrial. Rrjedhimisht, konsiderojmë që vendimi për të aplikuar tarifa industriale duhet t'i lihet KRU-ve.
- 2.28 Jemi të vetëdijshëm për disa shqetësime më të vogla, p.sh. në proceset e prodhimit të produkteve të qumështit, ku ujërat e ndotura janë dukshëm më të larta se ujërat e ndotura mesatare. KRU-të përkatëse duhet të përcaktojnë nëse impiantet e tyre të trajtimit të ujërave të ndotura mund t'i akomodojnë ato ujëra të ndotura dhe, nëse jo, ta ndalojnë shkarkimin në rrjetin e kanalizimit. Nëse nuk ndalohet, atëherë KRU-të mund të zgjedhin të vendosin tarifa industriale.
- 2.29 Ndërkohë, ne do t'iu ofrojmë udhëzime KRU-ve për mënyrën se si mund t'i përcaktojnë tarifatat industriale nëse duan t'i aplikojnë.

## 2.11 Mbrojtja për konsumatorët e cenueshëm

- 2.30 Gjysma e përgjigjeve, duke përfshirë ato nga KRU-të, kanë sugjeruar që konsumatorëve më të cenueshëm duhet t'iu ofrohet mbështetje.
- 2.31 Në disa përgjigje është refuzuar ky pohim dhe është cituar *Ligji për Rregullimin e Shërbimeve Ujore (neni 20, nën-paragrafi 3.2)* i cili thotë qartë që është 'përgjegjësi e institucioneve qeveritare, jo e ofruesve të shërbimeve, t'iu ndihmojnë konsumatorëve me të hyra të ulëta që t'i paguajnë faturat e tyre'. Ne supozojmë që kjo mbështetje ofrohet aktualisht përmes asistencës sociale të qeverisë dhe nuk ofrohen ndërhyrje të tjera nga kompanitë e ujit. Në këto përgjigje u sugjerua që kjo ishte qasja më e drejtë dhe më praktike.
- 2.32 Megjithatë, e kuptojmë që disa prej ekonomive familjare në gjendje më të vështirë financiare janë familje të mëdha ku konsumimi i ujit është pashmangshëm më i lartë. Analizat tona të mëhershme për ndër-subvencionimit sugjerojnë që mbështetja e bazuar në tarifa do të ishte jo efikase dhe do të çonte në gabime të konsiderueshme të përfshirjes dhe përjashtimit. Nëse është e nevojshme një lloj mbështetjeje, atëherë duhet të targetohet në mënyrë të mirëfilltë, p.sh. për ekonomitë familjare ku një apo më shumë anëtarë marrin asistencë sociale. Do t'i shikojmë më tej opsionet për asistencën e targetuar dhe, nëse është e nevojshme, do ta bëjmë një konsultim të veçantë rreth kësaj çështjeje konkrete.

### 3 Hapat e ardhshëm

---

#### 3.1 Pas këtij konsultimi, ne

- Do të punojmë me Qeverinë për të hartuar udhëzime për përfshirjen e përfitimeve mjedisore dhe sociale në vendim-marrjen e tyre për investime.
- Do ta shqyrtojmë statusin e objekteve fetare në kornizën e tarifave.
- Do t'i vlerësojmë opsionet për nxitjen e KRU-ve për ta përmirësuar performancën por duke i pasur parasysh kufizimet ekzistuese ligjore.
- Do ta ndryshojmë modelin për përcaktimin e tarifave për ta larguar masën për shtyrjen e nismave për përmirësimin e efikasitetit.
- Do t'i vlerësojmë më tej opsionet dhe implikimet e mekanizmit të ndëshkimeve për t'i kthyer paratë tek konsumatorët për investimin që nuk është realizuar dhe do ta ndryshojmë modelin për përcaktimin e tarifave për t'iu përshtatur propozimeve tona përfundimtare.
- Do t'i përcaktojmë kriteret për atë që pritet në një plan biznesi të cilësisë së lartë dhe do ta shqyrtojmë shpërblimin e planeve kualifikuese me kthim më të lartë në kapital.
- Do të nxjerrim udhëzime për KRU-të për largimin e ndër-subvencionimit aktual, periudha e largimit do të shqyrtohet më hollësisht.
- Do t'iu japim udhëzime KRU-ve për t'i zëvendësuar tarifat aktuale fikse me tarifa të bazuara në madhësi të lidhjes me kohë që KRU-të t'i mbledhin informatat e nevojshme dhe ta ndryshojnë sistemin e tyre të faturimit sipas nevojës.
- Do t'iu ofrojmë udhëzime KRU-ve për aplikimin e tarifave infrastrukturore të mbi ngarkesës
- Do t'iu ofrojmë udhëzime KRU-ve për aplikimin e tarifave të vlerësuara për ujërat e ndotura kur përdoruesit marrin ujë nga burime alternative dhe rrethanat e tjera ku aplikohen tarifat e vlerësuara për ujërat e ndotura.
- Do t'iu ofrojmë udhëzime KRU-ve për aplikimin e tarifave për ujërat e ndotura që të bazohen në cilësinë e ujërave të ndotura për përdoruesit e mëdhenj industrialë dhe përdoruesit e tjera ku mund të jenë të përshtatshme tarifat e tilla.
- Do t'i vlerësojmë opsionet për mbështetje të targetuar për konsumatorët e cenueshëm dhe, nëse është e nevojshme, do të bëjmë një konsultim tjetër publik.